

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1023 Prot.

Tiranë, më 02.08 2017

VENDIM Nr. 149, datë 26.07.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10, datë 26.07.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "Ndërtimi i nënstacionit 110 kV Orikum dhe Himarë, sëbashku me zgjatimet e linjave 35 kV"-subjekti "OST" sh.a.. realizuar nga ASHA,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "Ndërtimi i nënstacionit 110 kV Orikum dhe Himarë, sëbashku me zgjatimet e linjave 35 kV"-subjekti "OST" sh.a., realizuar nga ASHA.
2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve të sipërpërmendura identifikohen gjetje arkeologjike, bazuar në nenin 48 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 "Për Trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar), subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Vlorë dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETARIA KKA
RUDINA ZOTO

